

Historia e kishës shqiptare në një përmbledhje shënimesh të Karol Pooten-it. Figura prelatësh dhe provinca të rëndësishme kishtare¹

The history of the Albanian Catholic Church in the notes of Msgr Karl Pooten. Prelates and important ecclesiastic provinces.

Abstract: This paper focuses on the contribution of Msgr Karl Pooten to the identification of the dioceses and to the administrative subdivision of the Albanian Catholic Church. Such notes represent a chronological slice of the history of the Albanian church. They touch on very important events in the life of the local church including synods, councils and the pastoral and intellectual activity of different prelates. Cited by Msgr Pooten, prelates such as Pjetër Budi, Frang Bardhi or Pjetër Bogdani marked the history of the Albanian Catholic church after the death of Gjergj Kastrioti Scanderbeg. Another outstanding prelate that Msgr Pooten focused on in his notes was Msgr Vincent Zmajević. Apostolic visitor to Albania and supervisor of the Council of Albania (1703), the figure of Zmajević is one of the most cited in the notes of Msgr Pooten along with additional information about his origin, the family he was born into etc.

Author Paci maintains that the notes by Pooten deserve to be studied more in-depth because of their wealth of information about names of places and the register of the language used.

Keywords: Church history, history of writing, ecclesiastical hierarchy, philology of handwritten texts, early Albanian texts, Msgr Karl Pooten.

Studimet dhe kërkimet mbi të dhëna përherë më konkrete në lidhje me historinë e kishës shqiptare janë të lidhura ngushtë në pikëpamje kontributi me gjurmimet albanologjike dhe me drejtime mjaft specifike të ecurisë së tyre. E dëshmojnë një fakt të tillë një sërë punimesh që të afërta në pikëpamje objekti, por të ndryshme nga koha në të cilën janë përpiluar dhe kanë parë dritën e shtypit, të ndryshme dhe nga përmasat

1 Metropolis Antibarensis et Ecclesiarum Episcopatum in Albania Turcica sitarum, quae eidem Metropoli subsunt, vel olim subjectae fuerunt, Historia, quam ex Illyrico Sacro R.P. Danielis Farlati ad suum usum in Compendium redegit Carolus Pooten Archiepiscopus Antibarensis et Diocensis, Albaniae Metropolitae, ac Regni Serviae Primas.

dhe nga arritshmëria e objektit të vëmendjes, mbeten përherë ndërmarrje e sprovë orientuese dhe në drejtim të këndvështrimit që shfaq në lidhje me to historiani dhe arkivisti. Të tilla studime, por dhe relatime që të bëra objekt shqyrtimi nga medievalistët tanë janë hulumtuar vazhdimisht dhe në mjaft raste dhe përgatitur për botim, nuk mund të mos jenë dhe burime me vlerë për këdo që ushqen interesa studimore ndaj regjistrash gjuhësorë mjaft specifike, por dhe ndaj të dhënash që në raste të caktuara mund të hedhin dritë mbi historinë e familjeve të veçanta, por dhe të ngulimeve, vendbanimeve e trojeve që pikë së pari me ekzistencën e tyre dëshmojnë dhe lashtësi të pranisë së popullsisë shqiptare në viset e ndërmendura. Pa dyshim që burimet parësore në lidhje me periudha të caktuara të historisë së besimit të krishterë në viset tona mbeten relacionet e natyrës baritore që janë përpiluar në kohën në të cilën dhe nevojitej pasqyrimi sa më besnik i situatës dhe i gjendjes në të cilën ndodheshin popullsitë arbërore dhe objektet e kultit me të cilat ato ishin të lidhura ngushtë që në kohë të hershme. Gjurmimi i emërimit të këtyre objekteve të kultit bashkë me përshkrime në pamje të parë të natyrës gjeografike e territoriale nxisin dhe sot e kësaj dite kërkime dhe rishikime pikëpamjesh nga ana e arkeologëve të botës së krishterë, por dhe të studiuesve që jo vetëm interesohen për agjiografinë e botës shqiptare, por dhe për përdorimin konkret të librave a modeleve librorë që shpien në mënyrë konkrete në një lidhje të natyrshme që kisha dhe klerikët kishin me Selinë e Shenjtë në Romë. Në çdo rasë të konsiderimit të një materiali tejet të pasur burimor e njëkohësisht të larmishëm nga pikëpamje të natyrës së veprave që janë përpiluar për t'i shërbyer një qëllimi sa fisnik dhe shkencor, një materiali që ekziston prej kohësh në lidhje me këtë argument kompleks e që përfshin në radhë të parë studiuesit e historisë së kishës shqiptare, kontributi i Daniel Farlatit S.I. mbetet ndër më të rëndësishmit dhe në pikëpamje të të dhënave kyçe që arrin të ofrojë. Dhe pse nuk është objektiv parësor i kësaj trajtese të analizojë në hollësi çështje të trajtimit të historikut të kishave dhe dioqezave në një vepër të tillë si vëllimi VII i *Illyricum Sacrum*, ndërmendja e saj dhe referimi permanent do të përbëjë dhe një prirje të natyrshme të vetë ecurisë së saj, duke e diktuar një fakt të tillë vetë tematika së cilës i jemi kushtuar, bashkë me përafrimin e natyrshëm që argumentet e zgjedhura nga personaliteti që qe shtysë për një ndërmarrje të tillë paraqesin nevojën e qasjes dhe analizimit konkret të të dhënave historike dhe gjeografike. Analizimi i një përndarjeje sigurisht të seleksionuar në disa pikëpamje dhe të konkretizuar në trajtesa që pasojnë njëra-tjetrën, siç dhe rezultojnë të jetë përmbledhja e realizuar me një kaligrafi të kujdesuar nga ana e Imzot Pooten(1863) presupozon dhe disponimin e një arsenali të konsiderueshëm qoftë sa u përket elementeve informative që nevojiten në të tilla rasa, aq dhe një predispozite për të orientuar lexuesin ndaj

një brendësimi të qartë dhe krejt afër objektivit të parashtruar prej vetë autorit.

Duke pasur në dorë prej pak vitesh shënime që të disponueshme nga ana jonë në format dorëshkrimi përbëjnë një përmbledhje që në pikëpamje përmbajtjeje të shpie në burime të ngjashme nga qëllimi i përpilimit, patëm gradualisht si shtysë dhe idenë për të trajtuar në mënyrë të thukët disa elemente të përmbajtjes së tyre, gjithnjë nën interesin dhe bindjen se dhe vetë brendia e saj do t'u vlejë gjithashtu gjurmimeve ndërdisiplinore në fushë të albanologjisë.

Proemium-i i këtyre shënimeve që në të vërtetë përbën parathënien e një vëllimi që për nga rëndësia e të dhënave që përmban dhe sot e kësaj dite përfaqëson një burim të mirëfilltë referimi, transmeton njëkohësisht dhe objektivat e autorit, bashkë me kritere të caktuara që atij do t'i hynin në punë për t'iu përmbajtur një linje metodologjike në përpilimin e ndërmarrjes së tij që nëse i qëndrojmë asaj çka ai vetë thotë në këtë parashtrësë, ka qenë iniciuar për t'i shërbyer një përdorimi të natyrës së rezervuar. Ndarjet adimonistrativo-kishtare që autori kishte për qëllim të trajtonte a përshkruante, kanë qenë ose vijojnë të jenë në varësi të Metropolisë së Tivarit. Duke pasur për pikë të qartë referimi përpilimet me të njëjtin objekt studimi të Daniel Farlatit, autori nënvizon dhe hollësi që në të vërtetë lidhen me sprovat e tij në lidhje me hartimin e një historie kishtare në formë përmbledhjeje, e cila kufizohet në kishat e sipërcituara dhe që sipas tij në punë e sipër ka marrë trajtën e një pune të mëvetësishme, fakt që dhe mund të verifikohet hap pas hapi në kuadrin e një përqasjeje dhe disa analizash të hollësishme tekstore dhe përmbajtësore. Duhet pohuar që në krye të herës që vëmendja e përpiluesit të këtyre shënimeve që na paraqiten të shkruara me një kaligrafi jashtë mase të kujdesuar ndaj vëllimeve të Farlatit është e padiskutueshme dhe mjaft herë e pohuar prej atij vetë me referenca ndaj paragrafesh, nënvizimesh dhe vështrimesh që në më të shumtën e rasteve dëshmojnë qartë përmasën e kritikes. Do të mund të thoshim që pavarësisht objektivit në pikënisje të autorit të tyre dhe ecurisë që ka zgjedhur t'u japë trajtesave të caktuara nga ana e tij, një sprovë e tillë mund të konsiderohet jo thjesht një *Compendium* (duke iu referuar emërtesës së përdorur nga vetë Pooten), por dhe një lloj recensionit të paktën në lidhje me të njëjtat argumente apo trajtime në lidhje me personalitete të caktuara që nuk mund t'i mungonin kuadrit kompleks historik e historiografik të përvijuar prej këtij të fundit.

Në të vërtetë, sprova të kësaj natyre kanë shërbyer e shërbejnë si elemente themelore për të rindërtuar një ngrehinë që për nga madhështia dhe vlera e elementeve historike që sillen nëpërmjet saj, përbën një monument kujtese e duke qenë se me të nënkuptojmë pikërisht historinë e kishës shqiptare në një vështrim diakronik, krejt natyrshëm do ta shohim

të bashkëlidhur me atë të viseve tona arbërore.

Proemium-i shënimeve të Imzot Pooten-it dallon për një natyrë koncize e përmbajtjen e thukët, por me të dhëna që një lexues të vëmendshëm e aq më tepër studiuesin e periudhës që qe shtysë për t'u realizuar një kontribut i tillë, e orientojnë ndaj burimesh të tjera referenciale që janë më se të domosdoshme për të brendësuar ecurinë e trajtesave që përmban ky korpus trajtesash. Në një vështrim krahasues me çka i ka shërbyer Farlatit në pikëpamje të introduktimit të analizimit të ndarjeve të mëdha gjeografiko-administrative në veprën e tij, sigurisht që burimet që mund të vilen nga Pooten janë më të pakta dhe më të përzgjedhura, ndërkohë që do të mund të vërehet fare qartë që dhe ky i fundit ka vetëdijen se pikërisht burimet që ndërmenden nga Farlati mbeten më të përshtatshmit në pikëpamje referencialiteti dhe besueshmërie shkencore. Dhe pse në një pamje të parë duket sikur në më të shumtën e rasteve Imzot Pooten ka vjelë me shumë gjasë dhe pa modifikuar thellësisht tekste të caktuara, sidomos ato që shërbejnë si pararendëse të shtjellimeve më të zgjeruara përmbajtësore në vijim, konceptimi në pikëpamje të përfshirjes së kishave, metropolive dhe dioqezave do të përbëjë një diferencim thelbësor e aspak të parëndësishëm nëse do të bëhej fjalë për të krahasuar qoftë qasjet e secilit ndaj veprave që kanë ndërmarrë të përpilonin, qoftë dhe rëndësinë që i kanë kushtuar të njëjtave argumente e që para së gjithash kanë të bëjnë dhe me saktësimin e varësisë së ndarjeve të caktuara administrativo-kishtare.

Është krejt e qartë që autorit i kanë shërbyer në proces të ndërmarrjes së tij burime që ndërkohë gëzonin një status miratimi e privilegji në rrethet e interesuara të hierarkisë kishtare, ndërkohë që qysh në krye të herës duhet nënvizuar nga ana jonë që ai ka konkretizuar kontributin e tij me tipare e prirje origjinaliteti e kjo jo vetëm në pikëpamje të orientimit që kanë marrë trajtesa të caktuara të tij, por dhe sa i takon shkrimtarisë që e shtjelluar në një gjuhë kulture për kohën përbën një tjetër vlerë të qenësishme që mund të gjurmohet e interpretohet si një tipar konstitutiv gjuhësor e tekstor i kësaj vepre.

Referimi i autorit ndaj një vepre madhore siç ishte një nga vëllimet e *Illyricum Sacrum*-it përbën ndër të tjera dhe një detyrim nga ana e tij, duke qenë se ekzistenca e këtij të fundit nënkupton një ndikim të domosdoshëm për këdo që do të ndërmerre një sprovë serioze siç ishte ajo e përshkrimit të një areali gjeoadministrativ që kishte të bënte para së gjithash me kishën e Romës dhe besimin e krishterë në viset arbërore, me gjurmimin deri në origjinë të përvijimit të një historie komplekse që përfshin treva të tëra dhe që u konkretizua dhe në këto shënime në një nomenklaturë të plotë që ravijëzohet në emërtime specifike, në nëndarje që do të ridimensionohen në vazhden e rrethanave të caktuara historike, në një mozaik kompleks që

përfshin territore të gjera në pikëpamje të shtrirjes gjeografike, por dhe me interes të veçantë për ngjarjet që bënë të mundur që pikërisht disa prej tyre të ndërmendeshin nga kujtesa historike. Denominime konkrete nga ana e autorit të këtyre shënimeve (ashtu si dhe në aktet e Konkilit të dytë të Arbënit, 1871) mund të bëhen fare mirë objekt i vëmendjes së studiuesve të historisë që kërkojnë dhe referenca ndaj emërtimeve që dëshmojnë për viset shqipfolëse e një fakt i tillë nuk do të përbëjë thjesht shfaqje sporadike në vazhden e këtyre shtjellimeve.²

Proemium-i i sipërcituar përbën një model të mirëfilltë në pikëpamje të saktësisë së shprehjes që është meritë e shprehësisë së vetë autorit, por ndërkohë dhe paraqitet si shembull konciziteti duke qenë se bën të lexohet mjaft qartë synimi i përshkallëzuar i përpiluesit të këtij korpusi që duke respektuar një detyrim pikë së pari etik në drejtim të ndërmendjes së një reference themelore siç është vëllimi i mirënjohur i D.Farlatit, bën me dije dhe prirjet e tij për të rimarrë, sqaruar a nënvizuar fakte të tjera që ai gjykon të nevojshme t'i bëjë të ditura. Pas mendimit tonë, një parashtresë e tillë kthehet në domosdoshmëri për lexuesin dhe për vetë autorin e saj, duke qenë se pa pasur të qarta objektivat e këtij të fundit në lidhje me një punë të tillë aspak të lehtë e mjaft impenjative, paraqitet e vështirë dhe ndjekja e ecurisë së përshkrimit të njësive administativo-kishtare që bëhen objekt analize dhe vëmendjeje.³

Në këtë pikëpamje parashtrimi në njëfarë mënyre dhe i elementeve që ai i bën të dallueshme në proces të punës së tij gjen orientim e shprehje pikërisht në këtë tekst hyrës, që për afron në disa hollësi me modele të tjera analoge, po të gjurmueshme në vepra të paracaktuara për botim e që

2 Në jo pak raste autori ka synuar të ndërmendë dhe rrethana të largëta në kohë, për më tepër nën konditën e një saktësimi të domosdoshëm kronologjik. Këtij aspekti i vishen dhe përshkrime që i përshtaten më së miri një panoramë që kur bëhet fjalë për të trajtuar e analizuar kontekste që kanë të bëjnë me antikitetin e mesjetën, janë më se të natyrshme në përpilime të kësaj natyre. Në të vërtetë, të tilla paragrafe përbëjnë përkime të qarta me frymën analitike dhe deskriptive që shoqëron trajtesat që ndërtojnë përmbajtjen e veprës madhore *Illyricum Sacrum*.

3 *Proemium*, f.3: Sub initium anni 1863, proxime elapsi ex celeberrimo P.Danielis Farlati opere, quod *Illyricum Sacrum* inscribitur, historiam Ecclesiarum Episcopaliū in Albania Turcica sitarum, quae Metropoli Antibarensi subditae sunt, vel olim fuerunt, ad proprium usum in compendium redegimus. Cum vero in codice nostro alia corrigenda, alia addenda esse deprehendissemus, ac nonnulla insuper uberius explicare cuperemus, alterum exemplar conficiendum duximus, atque eodem anno confecimus. Nam non solum iterum aliqua invenimus quae corrigenda, alia et sane non pauca quae addenda sunt, sed et Ecclesiae Alexiensis historiam adjudendam esse censemus, cum haec quoque Ecclesia, secus ac hactenus putaveramus, Archiepiscopo Antibarensi subdita sit. Tertio itaque manum operi admoveamus necesse est. In hoc autem novo codice, paucis de Ecclesia Diocletana verbis praemissis, a Metropoli Antibarensi, cujus historiam in codicibus paullo ante citatis minime descripsimus, sed hic texere non abs re esse arbitramur, initium ducemus.

gjithashtu mund të konsultohen pasi kanë parë dritën e botimit.⁴

Qasja me tekstet e veprës madhore *Illyricum Sacrum* përbën një konditë të domodoshme nëse në pikëpamje të hulumtimit të trajtesave që përmban kjo vepër e Imzot Pooten-it, e pasur me të dhëna jo vetëm të natyrës gjeografike (e që në rasën e një ndërmarrjeje të tillë paraqitet si domosdoshmëri), por dhe me një sërë indicesh që kanë të bëjnë me prelatë të kishës që mbeten pjesë e një historiku që sa herë ka qenë e mundur, është gjurmuar që në origjinën më të largët prej autorit.

Autori ka kryer analiza që priren në pikëpamje të dhënash ndaj disiplinave themelore të dijes, por ka pasur patjetër dhe vetëdijen që do të ishte kontribues duke informuar mbi përkatësinë etnike, mbi kufizime të mundshme territoriale, mbi referenca të dhëna nga historiografë të antikitetit apo të mesjetës, mbi shtrirjen në pikëpamje territoriale të përdorimit të një gjuhe të caktuar, mbi ndryshime në pamje të parë të natyrës administrative, por me mjaft ndikim në ecurinë e praktikës së liturgjisë dhe forcimin e besimit të krishterë në vise të caktuara.

Marrja në konsideratë e ngjarjeve që kanë shënuar ndjeshëm historinë e viseve dhe të popujve të provincave të caktuara ballkanike e më saktë të asaj Dalmatine e më tej të Shkodrës, Lezhës etj., presupozon dhe analiza të kujdesshme të autorit vetë, por dhe një premisë për të realizuar trajtesa që pikërisht historinë e rrënjës dhe të përforcimit të një besimi të pranishëm tashmë në viset e ndërmendura do ta kenë në qendër të vëmendjes.

Duke iu rikthyer vitit që vetë autori ndërmend në parashtresën e kësaj vepre (1863), por më tej dhe në proces të përpilimit të kapitujve a krerëve që e ndërtojnë atë, duhet të kemi parasysh që ndërkohë një distancë prej më se një shekulli e ndan realizimin e kësaj të fundit nga botimi i akteve të Koncilit të parë të Arbënit (1706), që sigurisht është pjesë e trajtesave të veçanta në të, bashkë me referimin ndaj personaliteteve që kanë qenë iniciatorë dhe mbështetës në kuptimin e realizimit të tij. Do ta mbështesin një fakt të tillë zëra të veçantë në përbërje të kësaj vepre, ndërkohë dhe një dokumentacion konkret dëshmon qartë interesin e Imzot Pooten-it ndaj receptimit më të qartë të teksteve të Akteve të këtij koncili. Një fakt i ditur tashmë përbën dhe ngulmimi i këtij të fundit për një ribotim të përmirësuar të teksteve të shqipëruara të akteve të këtij koncili, fakt që mbështetet nga

4 Mund të bëhet objekt vëmendjeje dhe një paragraf i shkurtër përmblyllës që autori vendos në përfundim të trajtesave të tij mbi Kishat e përfshira në këtë përmbledhje, f.295: **In hac historia, quam ex Illyrico Sacro R.P.Danielis Farlati ad nostrum usum summam excerpsumus, imo ad verbum, ubi fieri potuit, exscripsimus, nonnulla quae non solum nostrum, sed elapsa quoque saecula respiciunt, et in Illyrico Sacro desiderantur, addidimus, alia vero, quae a celeberrimo Auctore minus recte affirmari nobis videbantur, examini subijcienda esse censuimus.**
Antibari, die 1.Maji 1865.
Carolus Archiepiscopus.

dëshmi konkrete të lëna me shkrim në parathënie të një vepre *ad hoc* nga Engjëll Radoja, kujdesues i variantit të mëvonë të këtyre akteve dhe në atë kohë dhe vikar i Arqipeshkvit Karl Pooten.⁵

Autoriteti i Imzot Pooten-it rezulton qartë në proces të konsultimit të akteve dhe teksteve të botuara që lidhen me Koncilin e dytë të Arbënit, që datojnë në kohë afërsisht me përpilimin e shënimeve të sipërcituara e që në të vërtetë dëshmojnë një lidhje të natyrshme me rolin që ky prelat i kishës pati dhe në këtë sinod që reflektoi sërish problematika konkrete në jetën kishtarë shqiptare dhe në një sërë nenesh që ishin cekur që në Koncilin e vitit 1703, jo pak herë të ndërmendur dhe të evokuar nga vetë Pooten në letrat dhe qarkoret që mbajnë autorësinë e tij. Referimi ndaj Koncilit të vitit 1703 mund të përforcohet nga një sërë citimesh dhe rimarrjesh që dëshmojnë dhe faktin që kjo ngjarje ishte e gjallë në kujtesën e autoriteteve të kishës arbërore. Një lidhje e natyrshme me rrethanat në të cilat u zhvillua ky koncil dhe objektivat që gjurmohen në dekretet gjegjëse të akteve të tij mund të lexohet fare qartë në krerë të caktuar të akteve të koncilit pasardhës, ndërkohë që tekste themelore që pikërisht dhe në shekuj që pasojnë koncilin e dytë janë bërë objekt trajtese, citohen në forma të plota duke u bërë kështu dhe shtysë për qasje dhe krahasime të natyrës tekstore.

Një dokumentacion të një natyre të ngjashme, por njëkohësisht të mbështetur nga një kornizë institucionale zyrtare përbëjnë tekstet me të cilat introduktohet kjo ngjarje po aq e rëndësishme për historinë e kishës së Romës dhe në veçanti për kishën arbërore, Koncili i dytë i Arbënit(1871). Të ashtuquajturat *Litterae indictionis* që mbajnë autorësinë e imzot Pooten-it janë dhe një tjetër dëshmi e faktit që kisha shqiptare njihet si një njësi e rëndësishme e krishtërimin në Evropë dhe një fakt i tillë dëshmohet qartë në artikullimin e një dokumenti të tillë me të cilin dhe sqarohet domosdoshmëria e mbajtjes dhe e thirrjes së një koncili të tillë kishtar. Përkujdesja për të nënvizuar rëndësinë e ripërtëritjes së dekretëve të koncilit paraardhës dhe nevojën e përshtatjes së disa prej tyre me realitetin konkret është mjaft e ndjeshme në përmbajtjen e këtij dokumenti hyrës, në të cilin do të shtjellohet mirë e bukur dhe platforma e këtij sinodi, që i kushtohet tërësisht kishës shqiptare dhe një problematike komplekse që duhej sqaruar rrënjësisht prej pjesëmarrësve. Shqyrtimi i këtyre teksteve hyrëse, sintetike në brendi dhe koncize në përmbajtje mbetet dëshmi e faktit që të tilla ngjarje historike që pasojnë njëra-tjetrën

5 Demiraj B., Engjëll Frang Radoja, në *Areali kulturor i Veriut në shek.XVI-XIX*, Botime Onufri, Tiranë, 2017, f.346-363. Shih në veçanti kreun me titull *Studiuesi i parë me tagrin e filologut në debatin albanologjik shqiptar(po aty, f.358-360)*, dhe shtojcën përkatëse(po aty, f.360-362) të titulluar: *Tejshkrim diplomatik i pjesës hyrëse të akteve shqip të Kuvendit të Arbënit të përkthyer prej Engjëll Radojës*(Romë 1872, f.5-9).

në të vërtetë shënojnë elemente të një ecurie që në diakroninë e vet përbën dhe një realitet krejt të veçantë dhe kompleks pa të cilin vështirë të mund të kuptohet historia e një vendi që gjeti te besimi dhe te feja një mbështetje të vazhdueshme, por dhe pësoi në mënyrë të vazhdueshme prej një pushtimi të gjatë dhe mjaft të rëndë. Do të vihet re fare qartë që referimi ndaj një faktori konkret siç ishte pushtimi otoman dhe ndikimi në mbarëvajtjen e jetës kishtare në viset arbërore është i dukshëm në shënimet me të cilat jemi marrë dhe në funksion të këtij kumtimi.⁶

Mbajtja e këtyre shënimeve nga ana e Imzot Pooten-it dhe që duhen konsideruar si një *Compendium* me vlerë i një historie komplekse, është e afërt në kohë dhe me mbajtjen e sinodit të sipërpërmendur dhe me ngjarje që i paraprinë jo rastësisht këtij të fundit. Dhe pse të nënvizuara jo pak herë prej autorit si shënime që kanë të bëjnë me *Illyricum Sacrum* e me kontributin e D.Farlatit, në raste konkrete do të vihet re që autori kishte fare të qartë çka do të konspektonte nga vëllimi i sipërcituar dhe çka do të konsideronte personalisht të një rëndësie parësore. Çdo rikthim ndaj paragrafesh që kanë të bëjnë me vetë thelbin e lëndës së sjellë prej autorit, çdo reflektim ndaj vetë mënyrës në të cilën është arsyetuar të strukturohet kjo e fundit, konkretisht ndaj një ecurie që bën të dallohet qartë hapësira kushtuar kishave dhe më tej personaliteteve që janë pjesë e historisë së tyre bën të kihet fare e qartë që autori nuk riprodhon pa qenë dhe vetë në brendi të asaj çka zgjedh të trajtojë.⁷ Do të gjendet pa dyshim në këtë përmbajtje dhe një nomenklaturë mjaft e kujdesuar sa u përket emërtimeve mbi kishat, dioqezat, ipeshkvitë, arqipeshkvitë, metropolitë e kështu me radhë.

Kemi të bëjmë me një model të ndryshëm në pikëpamje të konceptimit të një historie kishtare që mëton të ketë në konsideratë shtrirje gjeografike dhe momente historike, figura prelatësh që me kontributin e tyre shënojnë dhe një lloj vijimësie në këtë mozaik që përbëhet nga një sërë elementesh, ndër të cilat pikërisht komponentja historike do të ketë mjaftueshëm vëmendjen e autorit a përpiluesit të tij. Përpjekja e autorit për të gjurmuar gjer në origjinën më të largët të dëshmimit të gjurmëve të krishtërimit në

6 Përbën një të dhënë të një rëndësie po aq të madhe dhe brendia e së ashtuquajturës *Allocutio*, me të cilën Pooten, në cilësinë e arqipeshkvit të Tivarit e të Shkodrës i drejtohet këtij sinodi.

7 Do të mund të gjurmohet radha e mëposhtme e paraqitjes së kishave të Arbërit në proces të konsultimit të këtyre shënimeve të Imzot Pooten-it: Ecclesia Diocletana, f.4-7; Ecclesia Antibarensis, f.8-90; Ecclesia Alexiensis sive Lissensis, f.91- 117; Ecclesia Arbanensis seu albanensis, f.118-132; Ecclesia Balleacensis seu Balezensis, f.133-137; Ecclesia Dagnensis seu Daynensis, f.138-143; Ecclesia Drivastensis, f.144-158; Ecclesia Dulciniensis, f.159-171; Ecclesia Pulatensis Major et Minor, f.172-194; Ecclesia Sardensis et Sappensis, seu Sappatensis, f.195-225; Ecclesia Scodrensis, f.226-266; Ecclesia Svaciensis, f.267-277.

viset që ka marrë në shqyrtim ka bërë të mundur që dhe në pikëpamje datash dhe kufijsh kronologjikë të disponojmë të dhëna me vlerë që të evidentuara në formatin e një regesti të sistemuar me mjaft sqimë prej përpiluesit të vet bëjnë të mundur të ndiqet dhe ecuria konkrete në kohë e të dhënave që e ndërtojnë gjithë këtë histori sa komplekse, aq dhe të veçantë për studimet shqiptare.

Duke iu përmbajtur mendimit që shënimet e Imzot Pooten-it përbëjnë një korpus tekstor dhe në pikëpamje kompaktësie dhe koezioni përmbajtësor, do të donim të nënvizonim disa veçori të përmbajtjes së tyre:

Një vështrim interesant në pikëpamje përshkrimi dhe trajtimi paraqitet ai mbi Kishën e Dioklesë, që në disa elemente dallon qartë nga paragrafi gjegjës me të cilin dhe çelet përmbajtja e vëllimit VII të veprës *Illyricum Sacrum*. Është më se e qartë që autori (Pooten) lidh natyrshëm gjithë historikun e kësaj kishe dhe statusin e saj si Metropoli e ngjarjet historike që lidhen me ndryshime dhe të natyrës administrativo-kishtare me fillimet e kishës së Tivarit, që për hir të së vërtetës do të përshkruhet në një nga krerët më të gjerë në pikëpamje përmbajtjeje dhe vëmendjeje nga vetë autori. Pa asnjë dyshim që Dioklea është trajtuar më gjerësisht në çdo pikëpamje në veprën e Farlatit, duke qenë se në këtë të fundit do të evidentohen më me hollësi dhe hierarkët e pakët që figurojnë prej kësaj të fundit e që rezultojnë se vetëm ndërmenden në shënimet që kemi marrë në shqyrtim.⁸

Kisha e Tivarit do të gëzojë pa dyshim një interes tejet të veçantë në të dyja veprat, ndërkohë që pikërisht në shënimet me të cilat dhe jemi marrë këto kohë do të gjurmohet në vise të caktuara dhe një diversitet i qartë dhe i vetëdijshëm nga ana e Pooten-it. Një krye me interes përbën dhe nëndarja që i kushtohet kishës së Lezhës (*Ecclesia Alexiensis sive Lissensis*, f.91-94), duke pasur parasysh që dhe pas evidentimit të rreth 40 hierarkëve të kësaj kishe në një rend të natyrës kronologjike ashtu si në pjesët e tjera përbërëse të kësaj përmbledhjeje, do të mund të konsultohet kësaj radhe në gjuhën italiane një trajtesë e thukët me titull *Sulla dipendenza del Vescovo di Alessio in Albania come suffraganeo dell'Arcivescovato di Antivari*. (po aty, f.115-117).⁹ Në të vërtetë, rikthimi në vëmendjen tonë i një observacioni

8 Shih dhe paragrafin përkatës në shënimet e sipërcituara nga Pooten, f.5: Vix tres Episcopi Diocletani, veterum monumentorum naufragio erepti, nobis innotuerunt, videlicet Evander an.circ.450; Paulus an.circ.590; et Nemesian an.circ.602. Paucos quoque Diocletianos Archiepiscopos ante urbis excidium proferre possumus, quorum tres primi anonymi sunt, quartus et postremus Joannes vocatur, qui an.circ.900 Sedem Diocletanam conscendit.

9 Shih dhe shënimin përkatës në gjuhën latine të dhënë po aty, në f.114 të këtij kreu, që ka të bëjë pikërisht me këtë çështje të varësisë së kishës së Lezhës nga Metropolia e Tivarit, kryesuar në atë kohë nga Imzot Pooten: Exemplum Epistolae ab E.mo Cardinali Barnabo die 1 Jul.1864 ad nos, dum Romae eramus, datae, et Documentorum eidem

thelbësor në hyrje të kësaj vepre të vënë në dukje nga vetë autori zbulon një qëllim konkret nga ana e tij në lidhje me ndërmarrjen e trajtesave të tilla, të cilat përbëjnë kontribute konkrete në drejtim të rindërtimit të historikut të kishave të Arbërit, në veçanti të zonave veriore e qendrore të vendit tonë.

Sa u përket referimeve ndaj prelatësh që në vështrimin tonë dhe tradicionalisht në studimet shqiptare përbëjnë dhe autorë që me veprat e përpilimet e tyre ravijëzuan një periudhë fort të rëndësishme për historinë e lëvrimin të shkrimit shqip, mund të themi që rimarrja nga ana e tij dhe në këtë *Compendium* e trajtimit të personalitetit të secilit bashkë me evidentimin e një sërë detyrash që u atribuohen si klerikë të kishës së Romës përbën një tjetër indic që një traditë tashmë në konsolidim dokumentare u njihte atyre kontribute dhe merita në shumë pikëpamje. Pa dyshim që një prej figurave që lakohen dhe trajtohen sa me konsideratë, aq dhe me një koncizitet shembullor, mbetet ajo e Vincens Zmajevich-it, ndërmendur për prejardhjen perastine, për edukimin e marrë prej Kongregacionit të Propagandës, për caktimin e mjaft detyrave që kishin të bënin me një sërë vetish të mira që i njiheshin në pikëpamje personaliteti.¹⁰ Natyrisht që si dhe në kreun gjegjës të veprës *Illyricum Sacrum* (*Tomus Spetimus*) me Zmajevichin do të lidhet patjetër një ngjarje fort me rëndësi për kishën arbërore dhe për çka ajo përjetonte kur u vendos të mblidhej një sinod kombëtar që njihet me emrin Concilium Nationale Albanum (1703), por dhe çështja e kujdesimit nga ana e tij e Akteve të këtij koncili.

Përfshirja në këtë *Compendium* e emrave të prelatëve që në pikëpamje dokumentare figurojnë si hierarkë të kishës së Sardës dhe Sapës shtron gjithashtu mundësi qasjeje ndaj natyrës së informacionit të përzgjedhur nga Pooten në vështrim të një prezantimi përmbledhës së veprimtarisë së secilit. Në pikëpamje të introduktimit të një historiku të domosdoshëm sa i përket çështjes së lashtësisë së të dyja selive ipeshkvnore, Sardës e Sapës, trajtimit në pikëpamje të koordinimit gjeografik, ndërmendjes në regjistra kishtarë e nga historiografë të kohës, çështjes së një konceptimi në unicitet të një varësie të vetme të tyre duke filluar nga një periudhë e caktuar kohore, Pooten dallon sërish për koncizitet dhe përmbajtje në kuptimin e ofrimit të të dhënave historike, por pavarësisht këtij fakti në përgjithësi përkimet dhe në pikëpamje datash a shekujsh me Farlatin janë pothuaj të qarta. Sa u përket shënimeve që kanë të bëjnë me Pjetër Budin, vërehet qartë

Epistolae adnexorum, quibus Ecclesiam Alexiensem Metropoli Antibarensi et esse, et semper fuisse subjectam demonstratur: (vijon më tej një tekst sintetik në gjuhën italiane që i drejtohet pikërisht Imzot Pooten-it, i cilësuar shprehimisht si Arqipeshkëv i Tivarit).

- 10 Shih dhe shënimet përkatëse në lidhje me këtë prelat të kishës së Tivarit, përkatësisht në f.68 të vëllimit të cituar: *Vincenzio Archiepiscopo Antibarensi et Ecclesiae Buduensis Administratori munus quoque Visitatoris Apostolici Albaniae a Clemente XI impositum est.*

që janë të thukëta dhe dallojnë në pikëpamje të dhënash nga ç' mund të konsultohet në veprën *Illyricum Sacrum*, pikërisht në paragrafin kushtuar këtij prelati (f.284) e në të cilin mund të gjurmohen elemente biografike më të zgjeruara e në lidhje me shkollimin dhe shërbimet meshtarake e baritore të këtij të fundit. Gjithsesi, në atë paragraf konciz që Pooten i ka kushtuar Pjetër Budit, vërehet fare qartë që referimi është bërë pikërisht në mënyrë përmbledhëse nga *Illyricum Sacrum*, vëllimi i Farlatit e një fakt të tillë e dëshmon dhe dhënia e varianteve të mbiemrit, që me sa duket është dhënë në dy trajta te Farlati. E njëjta gjë mund të thuhet dhe për shënimet që lidhen me dy ipeshkvij të tjerë, përkatësisht me Gjergjin dhe Frangun, pasardhës të familjes së Bardhejve. Vihet re në këto paragrafe që citimi i pasazheve të natyrës biografike (i referohemi në këtë rasë veçanërisht kreut që lidhet me Frang Bardhin, autorin e Dicionarit latinisht-shqip të vitit 1635) mund të kishte qenë më i plotë dhe në pikëpamje të përmbajtjes së asaj çka thuhet në vëllimin përkatës të veprës *Illyricum Sacrum*.

Veçanërisht në lidhje me Frang Bardhin mund të thuhet që përkimi ndaj asaj çka parashtrohet mbi të në *Illyricum Sacrum* qëndron në elemente citimi nga vepra apologjetike e tij mbi Gjergj Kastriotin (Skënderbeun) e për të cilën dhe ndërmendet në të dyja këto burime. Edhe në lidhje me të tilla paragrafe e në veçanti sa i përket faktit që ndërmenden dhe elemente që kanë të bëjnë me biografinë e individit, duhet vënë në dukje që pikërisht çka referojnë vetë personalitetet që merren në shqyrtim, përbën një burim të dhënash dhe mbi konceptimin e ndarjeve administrative e gjeografike, që kanë të bëjnë dhe me një konfigurim të kohës në të cilën këto vetë kanë lindur.¹¹

Siç dhe dihet, në *Illyricum Sacrum* (Tomus Septimus, Venetiis, MDCCCXVII) do t'i kushtohet një vëmendje e konsiderueshme çështjes së dallimit kufitar mes ipeshkvisë së Sapës dhe asaj të Lezhës, çështje në të cilën Frang Bardhi shihet e konsiderohet fort qartë i thirrur në kauzë.¹² Një dokumentim i hollësishëm i situatës që përfshin si vetë ipeshkvitë, si prelatët që qëndrojnë në drejtim të tyre do të përbëjë një burim të vlefshëm

11 Shprehimisht do të citohet në lidhje me Frang Bardhin në paragrafin gjegjës në *Illyricum Sacrum*, vëllim i cituar, f.285: **Franciscus Episc.Sardensis et Sappatensis XVI : Consanguineus Nicolai et Georgii Antistitum, ex eadem Blancorum familia, & Sappatensi oppido oriundus; quod ipse confirmat in suo Opere inscripto, Georgius Castriotus & c.suis et Patriae restitutus ; haec enim scribit ; Major pars Zadrimae patriae meae fuit sub imperio magnanimorum Principum Ducaginarum, & reliqua sub imperio Lechae Zachariae cum oppido Daino a majoribus suis condito, & per manus avorum suorum sibi tradito ; est autem Sappa Zadrimae regionis oppidum non exiguum. (I.S. ; f.285).**

12 Shih në veçanti Illyrici Sacri, Tomus Septimus, Venetiis, MDCCCXVII, Suffraganei Metropolis Antibarensis, pikërisht *Litterae instrumentales: Decisivae confinium inter Episcopatum Sappatensem & Alexiensem, po aty, f.285 v.*

të dhënash mbi emërtime kishash e njësisht gjeografike, një pjesë dhe e sjellë në gjuhën italiane, përveçse në atë latine, siç figuron në shumicën dërrmuese të përmbajtjes së veprës së Farlatit. Në të vërtetë, më shumë se të flitet për Frang Bardhin, në këto paragrafe bëhet fjalë për çështje që kanë përfshirë dhe në pikëpamje kohore praninë dhe rolin e tij, ndërkohë që në përmbyllje të kreut kushtuar këtij të fundit nuk citohet me datë viti i vdekjes, po vetëm fakti që pas nëntë vjetësh që qëndronte në një detyrë të rëndësishme si ipeshkëv ndërron jetë nga një vdekje e parakohshme.

Po aq i thukët në pikëpamje përmbajtjeje në shënimet e sipërcituara figuron dhe paragrafi në të cilin flitet për të nëntëmbëdhjetin ipeshkëv të Sardës dhe Sapës, Stefan Gasparin, emri i të cilit na është bërë i njohur dhe përmes relacionesh që të botuara në disa numra të të përkohshmes *Hylli i Dritës* në vitet '30 të shekullit të kaluar, bashkë me të dhëna që lejojnë rindërtimin e një regesti emërtimeve dhe përshkrimesh gjeografike, na orientojnë sadopak ndaj Shqipërisë së Gjashtëqindës, më saktë një krahine specifike të saj.¹³

Paragrafi në të cilin do të gjejmë të dhëna mbi vendlindjen, shugurimin në një detyrë të rëndësishme baritore në *Ecclesia Scodrensis*, marrëdhëniet me familjarë që gjithashtu janë në të njëjtin rend ofiqesh kishtarë dhe fakte të tjera po aq thelbësore në lidhje me Pjetër Bogdanin, autor i një veprë madhore për kohën dhe për pasardhësit, përkon afërsisht në pikëpamje gjatësie dhe elementesh me çka ofron *Illyricum Sacrum* (*Tomus Septimus*) në kreun përkatës që i kushtohet të 35-tit ipeshkëv të kësaj kishe.¹⁴ Pjetër

13 Shih paragrafin përkatës në lidhje me këtë prelat në korpusin e sipërcituar, f.220: 19.Stephanus an.1673. -Cognomentum de Gasparis illi fuit. Patria Crojensis erat, alumnus primum Collegii Illyrici Lauretani, postea Romae in Collegio Urbano gravioribus disciplinis operam navavit. In Albaniam reversus Apostolici Visitatoris munere per illius provinciae Dioeceses Multa um laude functus est. Erat sexagenario major, et e triginta et amplius annis presbyter, dumque Dyrracchi commorabatur, Clemens X.IV Kal.Iunii an.1673 illum Sappensi et Sardensi Ecclesiae praeposuit Episcopum. Anno 1680.XVI.Kal.Martii e vita decessit, ut de illius obitu Budua scripsit eodem anno Dominicus Babichius Episcopus Scodrensis, qui Antonium Illium ejus Vicarium enixe commendat. P.Farlatius Stephanum patria Crojensem fuisse affirmat, et Cardinalis Othobonus in sua relatione illum natum esse dicit in Civitate Dyrrachiensi: uter eorum rem (acu) tetigerit, ignoramus.

14 Në shënimet e Imzot Pooten-it Bogdani figuron i 34-ti ipeshkëv i Kishës së Shkodrës: *Petrus IV, an.1656, po aty*, f.254. Ka diferencime të qarta mes dy teksteve të dy autorëve, dhe pse në pamje tëparë duket sikur dhe këtë herë Pooten ka konspektuar a përzgjedhur nga teksti i Farlatit(ky i fundit e trajton Pjetër Bogdanin në f.328 të vëllimit VII të I.S., në përbërje të kreut me titull *Archiepiscopi et Episcopi Scodrenses, Suffraganei Metropolis Antibarensis*). Të vihet re dhe paragrafi nga I.S., f.328, që nxit një vështrim kritik nga ana e Pooten-it e që ka të bëjë me saktësimin e periudhës në të cilën Bogdani ka udhëhequr kishën e Shkodrës, para se të merrte në dorëzim atë të Shkupit, pas abdikimit të vullnetshëm të të ungjit, Andrea Bogdanit: Hinc in Albaniam regrediens Uscopiam ad patruum suum Andream frequens itabat, ibique tamquam

Bogdani njihet si për ushtrimin e fesë, si për libra të botuar prej tij e veçanërisht një fakt i tillë vlerësohet së tepërmi në të dyja veprat që po marrim si burim referimi.¹⁵ Nga ana tjetër, do të jetë pikërisht Pooten në shënimet me të cilat plotëson zërin kushtuar Dominikut II(an.1677, me prejardhje nga Budva), f.255 që duke iu referuar qartë prologut të veprës *Cuneus prophetarum* të Pjetër Bogdanit dhe thënieve të këtij të fundit në të do të vërë pak më tej në diskutim çka thuhet te Farlati në lidhje me mungesën prej disa vitesh të ipeshkvit në Shkodër para se një detyrë e tillë t'i caktohej Dominikut, sigluar sipas Farlatit si i 36-ti ipeshkëv i kësaj kishe. Citimi në fjalë nga ana e Pooten-it përbën një dëshmi të faktit që kjo vepër madhore e Bogdanit jo vetëm njihej si e tillë, por përbënte dhe një burim referimi qoftë dhe sa i përket saktësisht të një jetëshkrimi konciz që në rastin e Pjetër Bogdanit është vënë në diskutim jo rrallë prej studiuesve të personalitetit dhe veprimtarisë së tij baritore.

Një paragraf të rëndësishëm mbas mendimit tonë përbëjnë dhe shënimet që lidhen me vetë personin e Pooten-it e në të cilat ka renditur të dhëna mbi prejardhjen familjare, vendlindjen, formimin human të prindërve të vet, inicimin e rrugëtimit drejt meshtarisë, plotësuar me hollësi që kanë të bëjnë me shkollimin në fushë të teologjisë së krishterë në kolegje papnore të kohës (autori ka ndërmendur dhe kolegjin Urban të Romës), por dhe me qëndrime shërbesash në vende të Ballkanit.

Përbën kjo trajtesë në të vërtetë një prej paragrafeve më të gjera të kësaj përmbledhjeje, ndërkohë që duket qartë që dhe shpjegimet e tij orientohen në mënyrë të theksuar ndaj periudhës që ka marrë administrimin e kishës së Tivarit dhe në të cilën dhe është përballur më konkretisht me problematikat që në njëfarë mënyrë dhe përmenden ndërsa flitet për rrethanat konkrete që kërkuar mbledhje sinodesh kombëtare apo dioqezane.

Në përpjekjen për të qenë sa sintetike, aq dhe evidentuese sa u përket momenteve që kanë shënuar veprimtarinë e secilit prej prelatëve që janë përfshirë në këtë vepër që e disponojmë në një variant të përpiluar me kaligrafi, rezultojnë dhe fakte që paraqesin interes dhe në pikëpamje të dhënash historike. Personalitete që lidhen dhe me historinë e shkrimit shqip ndërmenden në to, ndërkohë që janë shekujt përkatës me ndryshimet që dhe sot e kësaj dite konsiderohen si fryt i një konteksti specifik për

in portu ac perfugio sollicitudinem **et** laborum episcopaliū paullisper quiescebat; dum voluntaria Andreae abdicatione, ipse in ejus sedem metropolitācam successit, relicta post sexennium Ecclesia Scrodrensis. Shprehimisht te Pooten(*po aty*, f.254) do të gjindet si më poshtë ky pohim i thukët mbi veprimtarinë e Bogdanit: **Anno dein 1677 Andreae patruo, qui nuntium Archiepiscopatuī remiserat, in Sedem Scopiensem successit.**

15 *Illyrici Sacri, Tomus Septimus*, f.328: In act.Consist. is Patria Prisrensis in Serblia ex illustri familia Bogdana, et Collegii Illyrici Lauretani alumnus doctrina librisque a se editis plurimum claruit.

Ballkanin që afrojnë me njëri-tjetrin hierarkë dhe misionarë të kishës së Romës, jo të gjithë me prejardhje shqiptare.

Janë të një vlere konkrete dhe evidentimet e natyrës epigrafike që sillen prej tij dhe përbëjnë dëshmi kujtese në lidhje me figurat që mbeten pjesë e historisë së kishës të Tivarit, siç është dhe rasti i të ashtuquajturave *Inscriptiones*, të përfshira në një pjesë më vete të këtij korpusi, të titulluar pikërisht *Additamenta*.¹⁶

Vëzhgimi ndaj përmbajtjes dhe mënyrës së arsyetuar për të radhitur të dhëna mbi njerëz dhe ngjarje, por dhe mbi koordinime të natyrës gjeografike e që pikërisht në ditët e sotme paraqesin interes për disiplina si gjeografia kishtarë dhe historiku që mund të rindërtohet në lidhje me viset e ndërmendura në to na shtyn të mendojmë që autori me shumë gjasë mbas përfundimit të përpilimit të këtij *Compendiumi* mund të rimerrete me objektiva paksa të ndryshme hollësitë që vetë kishte përzgjedhur të konkretizonte në shënimet e tij. Mbështesin këtë mendim tonin rimarrjet mbi çka shkruan në faqet kushtuar kishës së Tivarit, historisë komplekse të saj dhe çështjes së statusit juridiko-administrativ në shekuj. Në çdo rasë rikthimi mbi përmbajtjen e paragrafeve që ndërtojnë çdo kapitull më vete, por dhe shtojcat që i bashkëngjiten disa prej tyre është fare e qartë që ky *Compendium* nuk është i një natyre thjesht evidentuese, pa pasur vëmendjen reflektive të autorit të tij dhe pa u shoqëruar me ndonjë vërejtje që e bën këtë të fundit më shumë se përmbledhës të dhënash që mund t'i dispononte nga regjistra kishtarë që kishte pasur mundësi të konsultonte, jo vetëm nga Farlati. Pikërisht Farlati do të jetë një prej burimeve më të rëndësishme në pikëpamje referencialiteti dhe një fakt i tillë mbetet ndër më të nënvizuarit dhe prej vetë autorit në proces të shtjellimit të krerëve që ndërtojnë gjithë përmbajtjen e këtij korpusi. Çështja e vlerësimit të trajtesave të konsultuara nga Farlati përbën mandej një tjetër argument diskutimi, duke qenë pikërisht dhe në vëmendjen e Pooten-it sqarimi i disa rrethanave që kanë të bëjnë me rolin konkret të prelatëve të kishës shqiptare një prioritet i qartë dhe në veprën e tij.¹⁷ E provon një fakt të tillë dhe trajtesa e zgjeruar në përmasa shtojce nën titullin *Quaestio dilucidanda*, me të cilën përmbillet dhe kapitulli më i gjatë i vetë kësaj përmbledhjeje, kushtuar kishës së Tivarit. Qëndrimi kritik ndaj asaj çka thuhet e lexohet te Farlati është më se i qartë dhe mund të ndeshet në gjithë përmbajtjen e paragrafit të sipërpërmendur. E mbështetin këtë mendim tonin dhe raste të tjera në të cilat autori gjen mundësinë për t'u shprehur mbi rrethana e

16 Shih pikërisht në kreun e sipërcituar, f.82: *Additamenta*: In fronte antiquae Aedis Cathedralis S.Georgio Martyri sacrae tres sequentes inscriptiones defunctorum Archiepiscoporum Antibarensium marmori incisae exstant.

17 Shih më konkretisht paragrafin me titull *Quaestio dilucidanda*, pikërisht në përmbyllje të kapitullit mbi kishën e Tivarit, f.84-90.

fakte që mbeten për t'u riparë apo verifikuar në lidhje me kufij kohorë që kanë të bëjnë me personalitete të një rëndësie parësore për historinë e Shqipërisë dhe për studimin e saj. Nuk mund të mbeten jashtë vëmendjes paragrafe në të cilat bëhet fjalë për heroin kombëtar Gjergj Kastriotin dhe fatin e familjarëve të tij, një fakt ky që nuk ka mbetur pa u ndërmendur as në këto shënime. Mund të receptohet pa dyshim një njohje e mirë nga ana e tij e historisë së Skënderbeut, ndërkohë që është fare e qartë që dhe ky i fundit nuk ngurron ta bëjë këtë figurë historike pjesë të trajtesave të tij, sa herë paraqitet e arsyeshme.¹⁸

Në shënimet që përmban një korpus i tillë ndihet qartë prirja për të ndërlidhur faktet e trajtuara apo personalitetet që citohen me aktualitetin dhe historinë bashkëkohore të kishës shqiptare. Vëzhgimi dhe interpretimi i fakteve më të afërta në kohë për autorin vetë mund të paraqesë lehtësi dhe në pikëpamje interpretimi apo verifikimi, duke qenë ky i fundit një objektiv përherë i pranishëm në parashtrësat me të cilat ai ka pajisur këtë përmbledhje. Nga ana tjetër, dhe ndërmarrja e konkretizuar në përpilime dhe pranëvënie faktesh dhe elemente të një realiteti që në sytë tanë përbëjnë një histori më vete dhe një periudhë që do t'u përkasë përherë e më shumë studimeve komplekse mbi historinë e kishës shqiptare, është bërë nën synimin për të përshkruar një kontekst të veçantë në sytë e autorit vetë, ndaj të cilit pa dyshim ai ushqen ndjenja afrimiteti dhe përfshirjeje të fortë.

Në përmbyllje të këtyre konsideratave që burojnë nga konsultimi i drejtpërdrejtë i indiceve me vlerë që përmban korpusi i sipërpërmendur, kishim në mend të parashtronim dhe çështje që kushtëzohen dhe nga një këndvështrim i disiplinës së filologjisë së tekstit, duke qenë se dhe një perspektivë e daljes në dritë të shtypit të tyre në një kontekst studimesh shqiptare mund të shtrojë një sërë argumentesh për t'u diskutuar. Riprodhimi besnik i shënimeve në gjuhën latine të Imzot Pooten-it sigurisht që mund të kërkojë dhe një ridimensionim të copëzave (shpjegimeve) që vendosen jo rrallë nga autori ose në përmbyllje të krerëve në të cilët dhe ka

18 Do të gjindet shprehimisht i cituar në shënimet e Pooten-it teksti në gjuhën latine: Thomas in quodam diplomate se ipso Principem Crojae appellat, propterea fortasse, ait P.Farlatus, quod gens Ursina non solum Popovi, sed etiam Crojae dominatum post interitum familiae Castriotae olim obtinebat. Sed hoc falsum est. Magnus enim Scanderbegus an.1467 moriens filium suum vix undecim annos natum una cum matre in regnum Neapolitanum secedere jussit, ibique morari, donec majorennis factus a Venetis in principatus sui possessionem mitteretur: principatum ipsum Venetorum tutela commisit, qui illum fidelissime semper tuiti sunt: an.1478 Turcae Crojam occuparunt, et hactenus tenent, quoniam igitur pacto, et quando gens Ursina post interitum familiae Castriotae Crojae dominatum obtinere potuit? Sed nec ante Scanderbegum ullum umquam vestigium ejusmodi dominatus invenimus. Ob quam porro rationem Thomas Principis Crojae titulum sibi adscripserat, nos prorsus latet. (f.56-57).

arsyetuar se duhet ndërtuar gjithë kjo përmbledhje e tij, ose në anë të tyre, duke u përafruar dhe me elemente të paraqitjes tipografike të vëllimeve që shihnin dritën e botimit dhe në atë kohë, por ndërkohë dhe shpjegime që nuk dëmtojnë përmbajtjen e tyre, por mund të burojnë dhe nga të dhëna të tjera jashtë teksteve të autorit vetë dhe që përgatitësi për botim mund t'i përfshijë duke pasur parasysh se mund t'u shërbejë sqarimeve të domosdoshme në mjaft raste.

Veçantia që paraqesin të tilla shënime dhe konsiderata që përmbledhin dhe çka thuhet në lidhje me të njëjtat argumente në vëllimin aq herë të cituar të *Illyricum Sacrum*(*Tomus Septimus*) del në pah jo vetëm duke nënvizuar diversitetin që vihet re që në ndarjet që autori bën duke dalluar a diferencuar mes trajtesës mbi kishat(emërtim i përgjithshëm ky) dhe më tej të dhënave mbi prelatët dhe hierarkët e secilës prej tyre, por dhe me faktin që përshkrimet që introdukojnë secilën prej krerëve të veprës së tij ndryshojnë jo pak prej Farlatit dhe pohimeve që përmbajnë paragrafet e vëllimit të kujdesuar prej tij. Një fakt i tillë nuk përjashton dhe një dukuri konkrete që ndeshet në çdo hyrje kapitulli dhe që ka të bëjë me gjurmimin e fjalive të njëjta që shpjegohen dhe me referimin permanent që me vetëdije të plotë Pooten ka pasur ndaj kësaj vepre madhore. Një qasje e domosdoshme, përherë e pranishme dhe në sytë tanë në një proces të leximit e të rileximit të këtyre shënimeve është bërë prej përpiluesit të këtyre radhëve me një vlerë të padiskutueshme në shumë pikëpamje, ndërkohë që dhe çdo studim që mund të ndërmerret dhe pas kaq kohësh do të marrë parasysh në ç'masë njëri dhe tjetri material studimor i është qasur një qerthulli argumentesh mjaft kompleks dhe shumëpërfshirës, siç është rimarrja në pikëpamje historike dhe evidentuese e ecurisë së një organizmi në rritje dhe ripërtëritje të vazhdueshme, kishës arbërore. Një çështje që bën të mundur që qasja mes dy autorëve të vihet në një perspektivë të mirëfilltë krahasuese, por dhe kritike mbetet ajo e varësisë së kishës së Lezhës, që siç dihet dhe për vetë Pooten ka paraqitur një interes të spikatur, duke pasur parasysh dhe faktin që është ndërmendur jo pak prej këtij të fundit duke filluar nga notat hyrëse të veprës së tij. Saktësimi i kësaj çështjeje është marrë në konsideratë dhe në trajtesat hyrëse që në *Illyricum Sacrum*(*Tomus Septimus*) i kushtohen Metropolisë së Tivarit e në veçanti kishave që kishin qenë apo ishin në varësi të kësaj të fundit(i referohemi në veçanti kreut me titull *Ecclesiae Episcopales Metropolis Antibarensis*, f.14 v.). Përbën dhe një argument i tillë një tjetër premisë që të nënvizojmë nga ana jonë që ky vëllim mbetet ekzemplar dhe sa i përket pasurisë së burimeve që citohen, vëmendjes permanente ndaj aspektit ortografik të sjelljes së emërtimeve a emërtesave që i interesojnë drejtpërdrejt rindërtimit historik e gjeografik të arealit që është bërë objekt vëmendjeje, shtrirjes dhe shtjellimit të arsyetuar që dhe falë gjerësisë së objektit të studimit qëndron më së miri

në natyrën e kësaj vepre.¹⁹

Një vepër e tillë sigurisht që më së pari duhet të jetë objekt i studimeve specifike mbi tekstet për vetë faktin që na paraqitet në një variant në dorëshkrim, gjë që nuk zvetënon rëndësinë e përmbajtjes dhe për më tepër dallon për saktësi trajtash dhe përpilimesh që vetë serioziteti i argumenteve të përzgjedhura i justifikon më së miri. Dhe në proces të një digjitalizimi të mundshëm, përgatitja e mëtejme për botim do të paraqesë nevojën e një aparati kritik të domosdoshëm e që do të përmbajë para së gjithash si domosdoshmëri komponenten historike dhe atë gjeografike, dhe kjo e fundit në një përmasë të qartë diakronike. Duke u bërë përherë e më të qarta përzgjedhjet që jo rrallë Pooten ka ndërmarrë në proces të konsultimit të veprës së Farlatit, konsiderimi i të dhënave që ofrojnë vëllimet e veprës *Illyricum Sacrum* përbën pa dyshim një prioritet për këdo që ndërmerr një punë të kësaj natyre, duke qenë këto të fundit burimet më të përfshira prej vetë autorit dhe çka ka më rëndësi për t'u nënvizuar dhe në këtë trajtesë, të ngjashme për nga destinacioni dhe jo fort të diferencueshme dhe në pikëpamje të kohës në të cilën u përpiluan gjithsecili. Edhe ky *Compendium* në të cilin historiani gjen dhe konfirmime të fakteve të sjella nga burime të ngjashme, por dhe vështrime kritike mbi rrethana apo pohime që të rishikuara vetëm do të përmirësonin të dhënat mbi periodha dhe mbi personalitete të caktuara; filologu gjurmon variante emërtesash mbi kisha, hapësira territoriale dhe monumente të një kujtese para së gjithash kombëtare; medievalisti do të vërejë pa dyshim se një vështrim qoftë dhe përgjithësues mbi përmbajtjen e kësaj vepre do të ketë domosdoshmëri të vetën ndërthurjen e një sërë kompetencash që nuk mbulohen nga një disiplinë e vetme, do të përbëjë një tjetër kontribut që në perspektivë të një përafrimi me studimet albanologjike ndërdisiplinore do të shquhet për veçanti dhe risi të konsiderueshme.

BIBLIOGRAFI

Bardhi P.O.F.M., *Udhëtimi i T'Emzot Marin Bizzit, kryeipeshkvit të Tivarit, nëpër Shqipëri në v.1610, në Zâni i Shna Ndout, n.VI, 1918.*
Concili Provinciale o Cuvendi J Arbenit(1706), botim kritik përgatitur nga Bardhyl Demiraj, Botime Françeskane, Shkodër, 2012.
Concilium Albanum secundum provinciale sive nationale, habitum

19 Fakti që dhe ky vëllim i Farlatit disponohet në një variant të shtypur dhe të përfunduar në pikëpamje tipografike e të revizionimit shkencor favorizon dhe konsultimin më komod të këtij të fundit, bashkë me shënimet që në veçanti kur shqyrtohen burime që kanë në përmbajtje dhe citime toponimesh a përveçimesh të ngjashme, përbëjnë një element më se të përshtatshëm orientues në aspektin filologjik dhe kritik.

- Anno MDCCCLXXI Pio IX. Pontifice Maximo, Romae, Typis S.C.De Propaganda Fide, MDCCCLXXVI.
- Dema B., *Shqypnija katolike në vjetë 1671*, në *Hylli i Dritës*, 7-8, 1932.
- Dema B.P., *Shtypi Françeskan në Shqypni*, në *Hylli i Dritës*, n.12, 1940.
- Dema B.P., *Shtypi Françeskan në Shqypni*, në *Hylli i Dritës*, n.11-12, 1941.
- Demiraj B., *Jetë rishtarësh shqiptarë në Kolegjin Ilirik të Feros (1663-1746)*, në *Hylli i Dritës*, n.1-2, 2015.
- Demiraj B., *Grimca biografike për autorët tanë të vjetër. I.Frang Mark Bardhi (1606-1643)*, në *Hylli i Dritës*, n.1, 2016.
- Demiraj B., *Grimca biografike për autorët tanë të vjetër. II.Andrea Bogdani(1607-1683); III.Rinia dhe formimi teologjik-intelektual i Pjetër Bogdanit; IV.Gjergj Toliq si hartues i Letrës së Pleqve të Gashit(1689)*, në *Hylli i Dritës*, n.2, 2016.
- Demiraj B., *Enciklika "Inter Omnigenas" e Papë Benediktit XIV (2 shkurt 1744) dhe roli i Imzot Gjon P.Nikollë Kazazit në përfitim të saj*, në *Shëjzat-Pleiades*, n.1-2, 2016.
- Farlati D., *Illyricum Sacrum (Tomus Septimus)*, Venetiis, MDCCCXVII.
- Kurti D.O.F.M., *Vepra kulturore e Elementit Katolik në Shqypni, Botim i Hyllit të Dritës*, Shtypshkroja Françeskane, Shkodër, 1935.
- Paci E., *Studime mbi tekstet e vjetra shqipe*, Botimet Albanologjike, Tiranë, 2017.
- Paci E., *La Madonna del Buon Consiglio, fonte ispiratrice di componimenti poetici nella tradizione letteraria albanese*, në *Il Veltro, Rivista della civiltà italiana, numero unico nel 550-esimo anniversario della morte dell'eroe nazionale albanese, përgatitur nga R.Sakja dhe F.Tagliarini*, 2019.
- Petrotta G., *Saggio di bibliografia albanese(1500-1930)*, Palermo, 1931.
- Prosperi A., *Il Concilio di Trento: una introduzione storica*, Piccola Biblioteca Einaudi, Torino, 2001.
- Malaj V.P., *Kuvendi i Arbënit(1703), Përshtatje në gegnisht dhe parathënie nga A.N.Berisha*, Tuz, 2017.
- Marlekaj L., *Pietro Bogdani e l'Albania del suo tempo(con la riproduzione fotografica di centotrentadue documenti)*, Liantonio editore, Palo del Colle, Bari, 1989.
- Paloka M., *Parathanie, në Kuvendi II(18719 dhe Kuvendi III i Arbënit(1895), Botim anastatik*, Botime Françeskane, Shkodër, 2015.
- Sarro I., *Kontribut për historinë kishtarë të Shqipërisë së epërme(shek.XVII-XIX)*, Botime Françeskane, Shkodër, 2015.
- Stadtmüller G., *Das albanesische Nationalkonzil vom Jahre 1703*, në *Orientalia Christiana Periodica*, v.22, Romë, 1956.
- Vrankić P., *Aktiviteti misionar në Shqipëri në dritën e sinodeve plenare shqiptare të shekujve XVIII dhe XIX*, në *Shëjzat-Pleiades*, n.1-2, 2016.

- Zamputi I., *Gjendja e materialeve dokumentare dhe burime të reja vendase për historinë e Shqipërisë për tre shekujt e parë të pushtimit turk*, në *Buletin për Shkencat Shoqërore*, n.3, 1955.
- Zamputi I., *Mbi disa materiale të reja dokumentare të shek.XVIII. Relacioni i Frang Bardhit mbi Pukën*, në *Buletin i Universitetit të Tiranës*, Shkencat Shoqërore, n.3, 1958.
- Zamputi I., *Pagine di storia dell'Albania (1506-1574)*, në *Rassegna di Studi Albanesi*, Anno II, n.1, 1962.
- Zamputi I., *Ricerche su Pjetër Bogdani*, në *"Rassegna di studi albanesi"*, Roma, n.1, 1964.
- Zamputi I., *Mbi rrethanat historike të botimit të "Mesharit" të Gjon Buzukut dhe vendin e tij në letërsinë e vjetër shqiptare*, në *Studime filologjike* n.3, 1986.
- Zamputi I., *Relacione dhe dokumente për historinë e Shqipërisë (1610-1650)/Relazioni e documenti per la storia dell'Albania (1610-1650)*, Albanisches Institut - "Faik Konica", Prishtinë, 2018.